

VENDIM
Nr. 412, datë 15.6.2022

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E
RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE, NË BASHKITË KAMZË DHE
LEZHË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, 25 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe të ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 152 560 950 (njëqind e pesëdhjetë e dy milionë e pesëqind e gjashtëdhjetë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë) lekë, për financimin e rindërtimit të banesave individuale për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rindërtimit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte që duhen rindërtuar nga e para sipas aktekspertizave të thelluara, në bashkitë Kamzë dhe Lezhë, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Bashkisë Kamzë, në masën 127 500 000 (njëqind e njëzet e shtatë milionë e pesëqind mijë) lekë;

b) Bashkisë Lezhë, në masën 25 060 950 (njëzet e pesë milionë e gjashtëdhjetë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë) lekë.

2. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për vitin 2022, nga bashkitë Kamzë dhe Lezhë, në masën 91 536 570 (nëntëdhjetë e një milionë e pesëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë) lekë, për financimin e rindërtimit të banesave individuale për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rindërtimit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte që duhen rindërtuar nga e para sipas aktekspertizave të thelluara, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Bashkisë Kamzë i transferohet fondi në formën e transfertës së pakushtëzuar, në masën 76 500 000 (shtatëdhjetë e gjashtë milionë e pesëqind mijë) lekë;

b) Bashkisë Lezhë i transferohet fondi në formën e transfertës së pakushtëzuar, në masën 15 036 570 (pesëmbëdhjetë milionë e tridhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë) lekë.

3. Efekti financiar për vitin 2022 të përballohet nga hapësira buxhetore e siguruar pas ngurtësimit në të njëjtën masë të fondeve të projekteve të rindërtimit me ecuri të ngadaltë dhe u transferohet bashkive Kamzë dhe Lezhë në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin e rindërtimit të banesave individuale për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rindërtimit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte që duhen rindërtuar nga e para.

4. Ngarkohen Zëvendëskryeministri dhe ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe bashkitë Kamzë dhe Lezhë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj